

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTLIGJIN**

#### **“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014 “PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke plotësuar disa mangësi që janë evidentuar ndër vite, gjatë zbatimit të tij.

Nëpërmjet projektligjit synohet rritja e meritokracisë, barazisë dhe efektivitetit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si disa nga shtyllat kryesore në të cilat mbështetet kjo forcë.

Meritokracia, përparimi në gradë i atyre ushtarakëve të cilët performojnë më mirë dhe përforcimi i piramidës së gradave, duke garantuar një numër progresiv rritës, janë çelësi i funksionimit të një strukture të armatosur me një mision të rëndësishëm kushtetues, siç është sigurimi i pavarësisë së vendit, si dhe mbrojtja e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues.

Për vetë objektivin e rëndësishëm që kanë Forcat e Armatosura, rregullimi i veçantë, për sa i përket administrimit të jetës së përditshme, është i domosdoshëm.

Pikërisht, ky projektligj do të garantojë përmirësimin e funksionimit të Forcave të Armatosura, duke përmirësuar aspekte të rëndësishme të karrierës ushtarake, siç janë: rekrutimi, mosha maksimale të shërbimit për çdo gradë etj.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji i propozuar nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2023, për Ministrinë e Mbrojtjes.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Përparësia e këtij projektligji është përmirësimi i situatës, për sa i përket përparimit në karrierë dhe vlerësimit të drejtë të punës së secilit ushtarak që shërben në Forcave të Armatosura.

Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka si objekt përcaktimin e normave dhe rregullave të hollësishme të rekrutimit, përparimit në karrierë dhe lirimit ose daljen në rezervë të ushtarakëve.

Problematikat kryesore, të cilat janë evidentuar nga zbatimi në praktikë i ligjit aktual, janë ulja e numrit të rekrutimeve, mungesa e një piramide të mirëfilltë, si pasojë e kufizimit të prurjeve të reja.

Këto ndryshime do të bëjnë të mundur përmirësimin e situatës aktuale, duke rregulluar balancat, rritur rekrutimet, mbajtjen e personelit dhe duke rritur përgatitjen dhe aftësitë e personelit ushtarak të Republikës së Shqipërisë.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet në tërësi nga **9 nene**, nëpërmjet të cilave bëhen disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Në nenin 1** përcakton se në nenin 13 të ligjit do të shtohet shkronja “ll”, me këtë përmbajtje

ll) Gjenerallejtënant Admiral 3 vjet.

Kjo shtesë bëhet për arsye se grada nuk është pjesë e nenit 13, dhe kjo shtesë bëhet me argumentin se, referuar Tabelës së Organizimit të Pajisjeve në Forcat e Armatosura, ka si funksion dhe gradën e lartpërmendur.

**Në nenin 2** ndryshohen shkronjat “a” deri në “ë” dhe shkronjat “g” deri në “j”, të pikës 1 të nenit 14, duke ndryshuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimit aktiv për një pjesë të personelit nënoficer dhe oficer, më konkretisht për gradat: “ushtar i I/detar i I deri në “ushtar IV”/“detar IV”, me 3 vjet”; “nëntetar” dhe “tetar”, me 3 vjet”; “rreshter” deri “kapter”, me 1 vit”; “nëntoger”/“nënlejtënant” deri në “kapiten”/“kapitenlejtënant, me 3 vjet”; gradat “major”/“kapiten i rangut të tretë”, me 2 vjet”; “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë”, me 1 vit”.

Për personelin nënoficer me gradën “kryekapter” dhe personeli oficer me gradën “kolonel”/ “kapiten i rangut të parë” dhe personeli oficer me gradën madhore nuk janë përfshirë në ndryshimin e moshës maksimale. Ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Mosha maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv, përcaktuar në shkronjat “a” deri në “ë” dhe nga shkronja “g” deri në shkronjën “j”, të pikës 1, të nenit 14 të ligjit ndryshohen dhe bëhen, si më poshtë:

|               |                           |          |
|---------------|---------------------------|----------|
| a) Ushtar I   | Detar I                   | 31 vjeç; |
| b) Ushtar II  | Detar II                  | 32 vjeç; |
| c) Ushtar III | Detar III                 | 33 vjeç; |
| ç) Ushtar IV  | Detar IV                  | 36 vjeç; |
| d) Nëntetar   | Nëntetar                  | 40 vjeç; |
| dh) Tetar     | Tetar                     | 48 vjeç; |
| e) Rreshter   | Rreshter                  | 55 vjeç; |
| ë) Kapter     | Kapter                    | 56 vjeç; |
| g) Nëntoger   | Nënlejtënant              | 36 vjeç; |
| gj) Toger     | Lejtënant                 | 41 vjeç; |
| h) Kapiten    | Kapitenlejtënant          | 48 vjeç; |
| i) Major      | Kapiten i rangut të tretë | 57 vjeç; |
| j) Nënkolonel | Kapiten i rangut të dytë  | 58 vjeç; |

Ky ndryshim është çmuar i arsyeshëm, sepse me rregullimet e deritanishme, do të bëjmë të mundur mbajtjen e personelit si domosdoshmëri për nevojat e Forcave të Armatosura. Si pasojë e uljes së numrit të rekrutimit del e nevojshme mbajtja e personelit që kemi në fakt. Shmangia e shtyrjeve të herëpashershme që bëhen për shkak të mungesave dhe boshllëqeve që krijohen në kompletim për arritjen e kapaciteteve operacionale të kërkuara.

Gjithashtu, duke marrë parasysh dhe ndryshimet strukturore të cilat janë në proces, ku do të kemi shtesë të funksioneve dhe të gradave në tërësi në Forcat e Armatosura dhe mundësia e sistemimit në detyrë nuk na paraqet probleme.

Gjithashtu, pika 2 në këtë nen bëhet dhe një riformulim i pikës 5 të nenit 14 të ligjit aktual duke rritur moshën e pranimit për t’u bërë pjesë si ushtarak aktiv nga 27 vjeç, sipas përcaktimit aktual në 30 vjeç. Si dhe duke bërë një përjashtim te rekrutimi deri në moshën 32 vjeç edhe për personelin e Orkestrës Frymore dhe të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura. Ky përjashtim është bërë për shkak të specifikës që mbart ky profesion dhe problematikës së rekrutimit.

Gjithashtu, ky ndryshim kërkohet për plotësimin e nevojave që kanë Forcat e Armatosura për rekrutim ku shtesa prej 3 (tre) vjetësh do të bëjë të mundur rekrutimin edhe të kësaj moshe, me qëllim plotësimin e nevojave në fakt që ne kemi. Gjithashtu, personeli i rekrutuar pas moshës 27 vjeç do të bëhet me një plan konkret, ku ky personel deri në plotësim të moshës maksimale do të shërbejë në struktura ruajte dhe mbështetje. Si dhe shkon në unison me jetëgjatësinë e moshës maksimale të kërkuar më sipër me një vit për çdo gradë.

Gjithashtu, ndryshimi i këtij neni ku mosha e pranimit nga 27 vjeç bëhet 30 vjeç, harmonizohet me nenin 4, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Pika 5, e nenit 14 riformulohet, si më poshtë vijon:

“5. Shtetasit, në momentin e titullimit oficer aktiv dhe ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 30 vjeç. Përgjithësisht bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficerë dhe ushtarë/detarë aktivë, të cilët do të jenë personel mjekësor, të Orkestrës Frymore dhe të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura të cilët në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç”.

**Me nenin 3** të projektligjit shtohet pika 7, në nenin 17, me këtë përmbajtje:

“7. Ushtarakët me gradë madhore, të cilët emërohen në detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, marrin gradën e funksionit të përcaktuar për këtë pozicion sipas Tabelës së Organizimit të Pajisjeve në Forcat e Armatosura.”

Ky ndryshim bëhet duke analizuar dispozitat e mësipërme të cilat përcaktojnë pozitën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, si ushtaraku me gradën më të lartë në hierarkinë e gradave, kriteret për përparimin në gradë dhe karrierë për ushtarakët me gradë madhore, si dhe autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e karrierës në Forcat e Armatosura, si dhe referuar funksionit më të lartë të parashikuar sipas Tabelës së Organizimit të Pajisjeve në Forcat e Armatosura (TOP).

**Neni 4** propozon të shtohet pas nenit 18, neni 18/1, me këtë përmbajtje:

#### **“Neni 18/1**

1. Gradimi i parakohshëm i ushtarakëve për gradën e radhës, mund të bëhet vetëm një herë gjatë karrierës ushtarake, jo më parë se një vit nga plotësimi i afatit kohor të qëndrimit në gradë.
2. Përgjithësisht nga përcaktimin i këtij neni ushtarakët aktivë nënoficerë me gradën “kapter” dhe oficerët aktivë me gradën “kolonel” dhe ushtarakët me gradë madhore.
3. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të ushtarakëve sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin ministrit të Mbrojtjes, në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.”

Një praktikë e tillë njihet dhe në ushtrinë amerikane dhe jo vetëm. Ushtarakët të cilët spikasin në fusha të caktuara të Forcave të Armatosura, janë të vlerësuar dhe kanë kontribut real dhe të bazuar nga eprorët, sipas linjave përkatëse të drejtimit e komandimit, si dhe plotësojnë të gjitha kriteret e përparimit në gradë të përcaktuara në ligj mund të përfshihen në kategorinë e ushtarakëve të cilëve u jepet e drejta për t'u shqyrtuar para kohe nga komisionet e karrierës për përparimin në gradë.

Kjo dispozitë do të motivojë ushtarakët e Forcave të Armatosura për të kontribuar dhe arritur rezultate në funksionet që ushtrojnë, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë duke ditur që mund të vlerësohen para kohës që përcaktojnë kriteret e përgjithshme të ligjit për përparimin në gradë dhe karrierë.

Në **nenin 5** të projektligjit janë parashikuar disa shtesa dhe ndryshime në nenin 22 “Komisionet e karrierës”.

**Pika 1.** Shkronja “b”, e pikës 2, të nenit 22, ndryshon dhe bëhet, si më poshtë:

“b) Komisioni i Lartë i Karrierës, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave “major/kapiten i rangut të tretë”, “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë” dhe “kolonel/kapiten i rangut të parë” dhe nënoficerët për marrjen e gradave “kapter dhe kryekapter”, si dhe personelin oficer për kualifikim nga grada “kapiten” deri në gradën “nënkolonel” dhe personelin nënoficer me gradën “rreshter” dhe “kapter”, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”

Ndryshimi i kësaj pike dhe riformulimi i saj vjen si rezultat i ndarjes dhe përcaktimit sa më të saktë të gradave që shqyrtojnë komisionet e karrierës, duke e harmonizuar dhe me pikën 1 të nenit 22, ku cilësohet kategoria e gradave që shqyrton për gradim dhe kualifikim.

**Pika 2.** Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 22, ndryshon dhe bëhet, si më poshtë:

“c) Komisioni i Zakonshëm i Karrierës vlerëson oficerët për marrjen e gradave “toger/lejtënant” dhe “kapiten/kapitenlejtënant”, si dhe personelin nënoficer “tetar” dhe “rreshter”, si dhe personelin nënoficer për kualifikim nga grada “nëntoger/nënlejtënant” deri në gradën “toger/lejtënant” dhe personelin nënoficer me gradën “nëntetar” deri në gradën “tetar”, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Komisioni i Zakonshëm i Karrierës ngrihet përkatësisht në Komandat e Forcave, Akademinë e Forcave të Armatosura, në Komandën Mbështetëse dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për repartet e vartësisë së drejtpërdrejtë dhe ato të Ministrisë së Mbrojtjes.”

Ky ndryshim bëhet për të përcaktuar dhe për të vlerësuar në gjykimin tonë, në mënyrë sa më të drejtë personelin e çdo strukture sipas performancës në fakt, ku kuotat të dalin në rang force sipas specialiteteve dhe konkurrimi të bëhet brenda çdo force dhe strukture. Komisioni i

Zakonshëm i Karrierës në rang force është propozuar të bëhet për shqyrtim të oficerëve dhe nënoficerëve, pasi është më i pakët dhe lind si e nevojshme që të jetë vetëm një komision.

**Pika 3.** Në logjikën e ndjekur më sipër, shkronja “ç”, e pikës 2, të nenit 22, të ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” propozohet të shfuqizohet, për arsye që të dyja këto kategori “oficer” dhe “nënoficer” do të jenë subjekt shqyrtimi në një komision karriere.

**Pika 4.** Shkronja “c”, e pikës 3, e nenit 22 “Përbërja e Komisioneve të karrierës”, ku citohet “Komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ulëta përbëhet nga...”, të ndryshojë dhe të bëhet “Komisioni i zakonshëm për oficerët dhe nënoficerët me grada të ulëta përbëhet nga..., pasi, sipas argumentimeve më sipër, komisioni i zakonshëm do të jetë i njëjtë për oficerët dhe nënoficerët me gradat e ulëta dhe përbërja e komisionit e njëjtë.

**Pika 5.** Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 22, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

- “Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore “gjeneral brigade/kundër-admiral”, ata zëvendësohen me oficerë me gradën “kolonel/kapiten i rangut të parë” dhe në rast mungese organike të oficerëve me gradën “kolonel/kapiten i rangut të parë”, ata zëvendësohen me oficerë me gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë.”
- “Komisioni i Zakonshëm i Karrierës ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes për të vlerësuar dhe propozuar për gradim e kualifikim oficerët me gradën “nëntoger/nënlejtënant, “toger/lejtënant” dhe nënoficerët me gradën “nëntetar”, “tetar” dhe “rreshter”, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”

Aktualisht në ligj është e përcaktuar me ndarje, pasi kemi dy komisione të zakonshme të karrierës për oficerët me grada të ulëta dhe nënoficerët. Ndryshimi i kësaj pike dhe shtesat bëjnë ndarjen përkatëse ku komisionet të shqyrtojnë personelin ushtarak sipas gradave që ata mbajnë.

**Pika 6.** Shkronja “ç”, e pikës 3, të nenit 22, të ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” propozohet të shfuqizohet, për arsye se të dyja këto kategori “oficer” dhe “nënoficer” do të jenë subjekt shqyrtimi në një komision karriere.

**Pika 7.** Fjalët “...dhe “ç”, të shkronjës “b”, të pikës 4, shfuqizohen.

**Pika 8** ndryshon pikën 5 të këtij neni, me përmbajtje, si më poshtë:

“5. Komisionet e karrierës, me përjashtim të Komisionit të Veçantë, i përfundojnë procedurat e punës së tyre brenda:

- a) muajit qershor të çdo viti, komisionet përgjegjëse për vlerësimin e ushtarakëve për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës;
- b) muajit tetor të çdo viti, komisionet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit në gradë të ushtarakëve.”

Ky ndryshim do të bëjë ndarjen e periudhave në të cilat mbledhen komisionet e karrierës për t'i dhënë mundësinë e konkurrimit për gradim të gjithë ushtarakëve të cilët plotësojnë moshën minimale për të konkurruar për marrjen e gradës së radhës brenda vitit kalendarik, si dhe për të mos penalizuar ushtarakët të cilët vlerësohen për kualifikimin e radhës në respektim të kohës së fillimit të vitit akademik përkatës.

**Neni 6.** Në këtë nen përcaktohen dy raste të kthimit në shërbimin aktiv. Me anë të nenit 7 të projektligjit propozojmë që, pas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 31 të ligjit, të shtohet shkronja “c”, si dhe një dispozitë për raste të tilla, me përmbajtje, si më poshtë:

“c) Për nevoja të specialiteteve dhe plotësimin e funksioneve që ndikojnë në ruajtjen e operacionalitetit të Forcave të Armatosura, por jo më shumë se 3 (tre) vjet. Me të drejtë rinovimi.

Në këtë përcaktim kërkojmë që, për nevoja të realizimit të misionit, Forcat e Armatosura të kenë mundësi për të kthyer në shërbimin aktiv personel ish-oficer, nënoficer dhe ushtarë aktivë, me qëllim arritjen e kapaciteteve operacionale, kur e kërkon misioni për specialitete të veçanta.

Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Procedurat, mënyra dhe rregullat për zbatimin e parashikimeve në shkronjat “a, b dhe c”, të pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin ministrit të Mbrojtjes,

Pika 3 parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor ku do të përcaktohen rastet e specialiteteve për të cilat ka mungesa organike dhe kërkohet plotësimi i tyre me personel që plotësojnë kriteret për rikthimin në shërbim aktiv. Rikthimi për këto kategori nënkupton se ushtaraku merr gradën që ka pasur në momentin e lirimit dhe nuk gëzon të drejta të tjera të parashikuara në ligjin për karrierën ushtarake.

Gjithashtu shtimi i pikës 3 ka diktuar dhe nevojën për nxjerrjen e një akti nënligjor që ishte vakum nga dispozita ligjore në fuqi.

**Neni 7** parashikon dispozita kalimtare.

Në dispozitat kalimtare parashikohet 1 pikë e cila parashikon qëndrimi në detyrë pas marrjes së gradës, për rastin e shefit të Shtabit në detyrë.

**Neni 8** parashikon aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Neni 9** parashikon hyrjen në fuqi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Mbrojtjes.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIUBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Projektligji do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET BUXHETORE**

Ky projektligj nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

**MINISTRI**

**Niko Peleshi**

